



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:192312
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05458525

C.nr.20/2016

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtari Petrit Curri në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.Sh.B.nga fshati Ll./Malishevë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Eleonora Berisha me adresë rruga “UÇK”, A1, 7/30 Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimit “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmit, vlera e kontestit 2,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 15.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. NDËRPRITET** procedura në këtë çështje juridike kontestimore me shenjën C.nr.20/2016, sipas padisë së paditësit, kundër të paditurës për kompensim dëmi, për shkak të hapjes së procedurës së falimentimit (procedurës së likuidimit të detyrueshëm) ndaj të paditurës “Kosova e Re” me seli në Prishtinë.
- II.** Procedura e ndërprerë në këtë çështje do të vazhdohet kur përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e merr përsipër procedurën, apo kur t’ a thërrasë gjykata ta bëjë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi R.Sh.B.nga fshati Ll./Malishevë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Eleonora Berisha me adresë rruga “UÇK”, A1, 7/30 Prishtinë, me datë 21.01.2016 ka parashtruar padi ndaj të paditurës Kompania e Sigurimit “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “Kompensim dëmi” në aksident trafikës, me vlerë të kontestit 2,000.00 euro.

Gjykata përmes aktvendimit procedural C.nr.20/2016 të datës 26.02.2024, në mbështetje të dispozitës nga neni 394 të LPK-së, padinë me të gjitha shkresat e bashkangjitura ia ka dërguar të paditurës, në mënyrë që t’i ofrohet mundësia për paraqitjen e përgjigjes në padi brenda afatit prej 15 ditëve në kuptim të dispozitës nga neni 395 par.1 të LPK-së.

Me datën 14.04.2024, Gjykata zyrtarisht ka marrë përgjigje në padi dhe është njoftuar se:

- Siguruesit “Kosova e Re” me adresë në lagjen “Kalabria” blloku B1, numër 5 Prishtinë, i revokohet licenca nr.007 e datës 25 prill 2002 nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, paraardhës ligjor i Bankës Qendrore të Kosovës.
- Ndaj Siguruesit “Kosova e Re” janë hapur procedurat e likuidimit të detyrueshëm sipas Ligjit Për Sigurimet nr.05/L-045.
- Bazuar në vendimin nr.70-24/2021 të datës 24.09.2021 z.N. L. emërohet Likuidator i Siguruesit “Kosova e Re” SH.A.- Kosovë.
- Dëshmia e dëmeve dhe pretendimet kundër siguruesit duhet ti dorëzohen Likuidatorit në procedurë të rregullt brenda 90 ditësh pas publikimit të fundit në gazetë.
- Pretendimet e dëmeve të cilat dorëzohen pas afatit ligjor prej 90 ditësh, mund të mos shqyrtohen nga ana e likuidatorit.
- Ndërpritet procedura gjyqësore në secilin kontest ku e paditur/debitor është KS “Kosova e Re” dhe të njëjtat kërkesa i ushtrojnë konform ligjit nr. 05/L-045.

Pra, Gjykata zyrtarisht është informuar se Banka Qendrore e Kosovës (BQK), me vendimin nr.70-24/2021 të datës 24.09.2021 i ka revokuar licencën Nr. 007 të datës 25.04.2002, Kompanisë së Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë dhe ka hapur procedurën e likuidimit të detyrueshëm.

Me rastin e vënies në dijeni të këtij fakti, gjykata iu referua dispozitës së nenit 277 pika d) të LPK-së, e cila përcakton se: “*Procesi gjyqësor ndërpritet: d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues*”, ndërsa me nenin 280, paragrafi 1 të po këtij ligji, është paraparë se procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277, pika a) - d) të këtij ligji, do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Gjykata vë në dukje se në kuptim të dispozitës nga neni 279 të LPK-së, si rezultat i ndërprerjes së kësaj procedure, rrjedhimisht ndërpritën edhe afatet për zhvillimin e veprimeve procedurale dhe gjatë kësaj kohe gjykata nuk mund kryej kurrfarë veprimesh procedurale, e po ashtu veprimet e kryera nga ndonjëra prej palëve ndërgjyqëse nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik ndaj palës kundërshtare, deri në momentin e vazhdimin eventual të procedurës.

Andaj, në një gjendje të këtillë dhe mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.20/2016, datë 15.03.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.